



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
**Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse**

**NJOFTIM**  
**PËR POZICION TË LIRË PUNE**  
**RECEPSIONIST NË SEKTORIN E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE NË DREJTORINË E BURIMEVE**  
**NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 74/2022, të Kuvendit të Shqipërisë, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e kuvendit nr. 67/2020, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, vendimit nr. 326, datë 31.05.2023, i Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shpall:

- 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin Recepsionist në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;  
Klasa e pagës II.

Afati për dorëzimin e dokumentave: data **26.01.2024**

Përshkrimi i përgjithshëm i punës (detyrat kryesore) për këtë pozicion janë:

1. Përgjegjës në sigurimin e rregullit të brendshëm për hyrje-dalje në institucion;
2. Mirëpret palët në ambjentet e institucionit, regjistron në regjistrin e vizitorëve, personat që nuk janë pjesë e stafit duke shënuar gjenealitetet me të dhënat personale, dhe pajisur ata me një dokument që i evidenton si “vizitor”;
3. Kryen edhe detyra të tjera në përputhje me rregulloren e brendshme të institucionit.

Kërkesa të përgjithshme për kandidatët

1. Të jetë shtetas shqiptar.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.

4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, që nuk është shuar sipas këtij ligji.
5. Të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;

Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë:

1. Të kenë arsim të mesëm;
2. Të ketë aftësi të mira komunikuese, bashkëpunuese, transparencë në punë.
3. Të jetë i disponueshëm të punojë jashtë orarit zyrtar të punës, në varësi të aktiviteteve.

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e protokollit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dokumentet e dosjes së tij personale:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
2. Një kopje të jetëshkrimit;
3. Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;
4. Fotokopje të dëftesës së arsimit të mesëm.
5. Fotokopje e librezës së punës, nëse ka;
6. Fotokopje të kartës së identitetit;
7. Vërtetim i gjendjes shëndetësore;
8. Vërtetim i gjendjes gjyqësore.

Për sqarime të mëtejshme, mund të kontaktoni në adresën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Rruga "Ibrahim Rugova", Nr.4, Tiranë, si dhe të konsultoni faqen zyrtare në internet [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al).

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse